

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

Sot me date 01.06.2022

1. Znj.Dorlana Frakulli I datelndjes 22.03.1983 shtetas Shqiptar me nr ID I35322078A.
 2. Z.Bledar Qalliu I datelndjes 03.11.1980 shtetas Shqiptar me nr ID. I01103074R
- e ne vijim do te quhen ortake: Bazuar ne vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", vendosen te hartojne kete statut per funksionimin e shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar "7 Moons", shpk ne baze te kushteve qe vijojne:

Kreu I

OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1. Objekti i shoqerise

1.1. Shoqeria ka kete objekt veprimtarie;

Te ushtroje aktivitetin ne fushen e shitjes me pakice dhe shumice te produkteve ushqimore . -
Produkte argjendari perpunimin shitjen tregtimin ne shumice dhe pakice. -Te
krijojne,bleje,financoje,investoje,te hyje ne marrdhenie te ndryshme me te tretet dhe kryeje
sipermarrje dhe projekte te ofroje sherbime dhe asistence te te gjitha llojeve personale, fizike,
juridike, perfshire dhe sherbimet, menaxhuese, konsulence, planifikuese, keshilluese, financiare,
investuese, teknike, administrative. Pevce veprimtarive te parashikuara me lart, ne veprimtarine e
shoqerise do te hyje cdo veprimtari qe do te konsiderohet nga Asambleja e Ortakeve/ Ortaku i
Vetem si e nevojshme dhe e pershtatshme per arritjen e objektit te shoqerise dhe qe nuk vjen ne
kundershtim me Ligjin shqiptar.

1.2. Shoqeria kryen çdo lloj veprimtarie te dobishme per arritjen e objektivave te saj, duke perfshire edhe veprime per shitblerje sendesh te luajtshme dhe te paluajtshme, pjesmarrje ne kuota dhe aksione ne shoqeri dhe ndermarrje te tjera.

Neni 2.Emertimi dhe Selia juridike e Shoqerise

2.1. Ortaket vendosen qe shoqerine ta emertojne "7 Moons", shpk .

2. Selia juridike e Shoqerise ndodhet ne Tirane Tirane Rruga e Elbasanit njesia bashkiake nr 2 nr i pasurise 6/30-N9/2 ZONA KADESTRALE 8150.

2.3. Shoqeria mund te krijojte qendra sekondare , filiale, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

Neni.3. Regjimi Juridik

3.1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Statutit, dhe legjislacionit ne fuqi ne Shqiperi.

3.2. Me vendim te tyre Ortaket mund te ndryshojne regjimin juridik te Shoqerise, n.q.s ne te ardhmen krijohen premlsa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast



Ortakët do të përshtasin Statutin e shoqërisë, si dhe do të bëjnë regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar në organet kompetente shqiptare.

3.3. Shoqëria gëzon personalltet juridik nga data e regjistrimit të saj në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe në përputhje me ligjin

3.4. Shoqëria do të ketë vullnet të saj

Kreu II

TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

Neni 4. Te drejtat e Shoqërisë dhe të Ortakut

4.1. Shoqëria ka të drejtë të lidhë marrëveshje dhe të nënshkruajë kontrata në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj.

4.2. Shoqëria gëzon të drejtën të krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.

4.3. Shoqëria ka të drejtë të marrë pjesë si ortakë në shoqëri ose ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri ose jashtë saj, në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

4.4. Shoqëria përgjigjet ndaj të tregëve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqëror të derdhur dhe me të mirat e pasurisë së saj. Ajo në asnjë rast nuk përgjigjet për detyrimet e ortakut dhe as ky i fundit nuk mban përgjegjësi personale për detyrimet që merr për shërbime shoqëria.

4.5. Ortakët kanë të drejtë të marrin të gjitha informatat që kanë të bëjnë me veprimtarinë prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare të Shoqërisë, si bilanci, llogaritë ekonomike, etj

4.6. Ortakët përballojnë humbjet e shoqërisë vetëm dhe deri në kufirin e vlerës së kontributeve të tij në kapitalin themeltar

Neni 5. Kohezgjatja

5.1. Kohezgjatja e Shoqërisë është me afat të pacaktuar

Kreu III

KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

Neni 6

6.1. Kapitali themeltar është 100.000 (Njëqind mijë) leke dhe është i ndarë në 2 (Dy) kuota

6.2. Ndarja e pjesëve në kapitalin themeltar është :

Znj. Doriana Frakulli	50 000 lek – 1 kuota, përkatesisht 50 %
Z. Bledar Qalliu	50 000 lek – 1 kuota, përkatesisht 50 %

6.3. Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakesohet sipas vendimeve që do të marrin ortakët

6.4. Ky kapital nuk mund të jetë më i vogël se minimumi i pacaktuar me ligj.

Neni 7- Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar

7.1. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme midis ortakëve të shoqërisë.

7.2. Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen, nga ortakët, personave të tjerë, që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e ortakëve

Kreu IV

DREJTIMI DHE ORGANET KRYESORE

Neni 8

- 8.1. Shoqeria fiton personalitet Juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.
- 8.2. Emertimi i shoqerise tregtare, kapltall themeltar, NIPT-I duhet te jene te permendura ne te gjitha aktet dhe dokumentat qe nxjerr kjo shoqeri dhe ju drejtohen te treteve.
- 8.3. Organet kryesore te shoqerise jane: Asambleja e Pergjithshme e perbere nga ortakët, administratori dhe eventualisht Eksperti kontabel i autorizuar.

Neni 9

Asambleja e Pergjithshme e shoqerise

Asambleja e pergjithshem perbehet nga ortakët e shoqerise qe eshte organi me larte vendimmarres i shoqerise dhe vendimet e tij jane te detyrueshme.

Te drejtat dhe detyrime t e asamblese se pergjithshme ushtrohen nga ortakët. Te drejten e thirrjes se Asamblese e kane Administratori, Eksperti kontabel i autorizuar ose ortakët e shoqerise. Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithë ortakëve, jo me vone se shtate dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Ortakët mund te perfaqesohen ne asamble nepermjet nje perfaqesuesi, duke qene i autorizuar me prokure te posacme, dhe te marrin vendime vetem per ato ceshtje qe diskutohen ne mbledhjen per te cilen ata kane marre te drejten e perfaqesimit.

Ortakët mund te ngarkojë nje mandatmbajtes te votoje ne emer te nje pjese te kapitalit te tij themeltar, duke votuar ai vete ne emer te pjeses tjeter te kapitalit te tij themeltar.

Mbledhjet e asamblese pasqyrohen ne procesverbalin qe mbahet me kete rast, ndersa vendimet nenshkruhen nga ortakët

Procesverbalet e mbledhjeve ruhen ne seline e shoqerise.

Te gjitha vendimet e marra nga ortakët regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen.

Ortakët e shoqerise kane te drejte te marrin vendime per ceshtjet e meposhtme:

- a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
- b) Ndryshimet e statutit
- c) Emerimin e shkarkimin e administratoreve
- ç) Emerimin e shkarkimin e likujduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.
- d) Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronja "c" dhe "ç" te kesaj pike.
- dh) Mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- e) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.



- ë) Zmadhimin dhe zvogellimin e kapitallt
- f) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- g) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- gj) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
- h) Miratimin e regullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese
- i) Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Kreu V ADMINISTRIMI

Neni 10

10.1. Shoqeria do te administrohet nga 1 (nje) administrator i vetem, i cili mund te zgjidhet edhe jashte ortakeve te shoqerise

10.2. Administratori emerohet dhe shkarkohet nga Ortaket

3. 10.3. Administrimi i shoqerise do te behet nga **Z.Bledar Qalliu i datelindjes 03.11.1980 shtetas Shqipetar me nr ID. I01103074R**

10.4. Kohezgjatja ne detyre e administratorit te shoqerise do te jete 5 (pese)vjet me te drejte ripertesitje ne perfundim te mandatit.


10.5. Administratori i vetem i ka te gjitha te drejtat e fuqite per drejtimin e zakonshem te shoqerise, me qellim arritjen e objektivave te saj.

10.6. Administratorit i takon firma e lire dhe perfaqesimi i shoqerise ndaj te treteve ne veprime, procedura dhe seanca gjyqesore, arbitrazhi ose administrative.

10.7. Administratori eshte pergjegjes, sipas rastit, ndaj shoqerise ose te treteve per shkelje te ligjeve , per shkelje te Statutit apo deme te kryera gjate ushtrimit te detyres

10.8. Kompetencat kryesore te administratorit ne shoqeri jane:

- kryen te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga ortaket :
- perfaqeson shoqerine tregtare.
- kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise.
- pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve i paraqet keto dokumente perpara ortakut te vetem per miratim
- krijon nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise.
- kryen regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme te shoqerise , sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit
- raporton perpara ortakeve ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare.
- kryen detyra te percaktuara ne ligj dhe statut.



- administrimin e pasurise se Shoqerise, duke perfshire mjetet financiare, brenda caqeve te lejuara nga ortaku.
- kryerjen e te gjitha veprimeve bankare ne interes te shoqerise
- te perfaqesoje Shoqerine me te tretet ne te gjithe veprimtarine e saj dhe te mbroje interesat e saj ne gjykate apo arbitrazh, nenshkrimin e kontratave ne emer te shoqerise dhe ndjekjen e zbatimit te tyre.
- ti propozoje ortakeve per miratim strukturen e aparatit te Shoqerise dhe krijimin e organeve te tjera te domosdoshme per realizimin e objektivave te Shoqerise .
- ti propozoje ortakeve per miratim numrin e punonjesve te Shoqerise, pagat dhe emerimin e shkarkimin e tyre.

Neni 11-Marreveshjet e ndaluara

11.1. Administratorit ose ortakut qe nuk jane persona juridike nuk u lejoht te kontraktojne ne cfaredolloj forme qofte, te marrin hua te shoqeria, te japin pelqimin ne emer te saj, per paradhenie si dhe te behen dorezanes apo te garantojne ne emer te saj angazhimet ndaj te treteve. Ne rast te kundert kontrata eshte e pavlefshme. Kjo mase ndaluese zbatohet edhe ndaj perfaqesuesve ligjore te ortakeve qe jane persona juridike.

11.2. Kjo mase zbatohet gjithashtu ndaj bashkeshorteve, paraardhesve dhe pasardhesve te personave te cituar ne paragrafin e pare te ketij neni, si dhe ndaj çdo personi ndermjetes.

Kreu VI

VITI FINANCIAR , LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMEVE

Neni 12

12.1. Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti i pare i cili fillon ne daten e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

12.2. Llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar , raportet e vecanta te hartuara nga administratori dhe eventualisht eksperti kontabel i autorizuar, miratohen nga Ortaket.

12.3. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda 3 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Neni 13-Kontrolli i Shoqerise

13.1. Kontrolli i Shoqerise kryhet nga nje Ekspert Kontabel i Autorizuar, i emeruar nga ortaku i vetem.

13.2. Eksperti kontabel i autorizuar garanton qe llogarite vjetore te shoqerise jane te rregullta, te hartuara me sinqeritet dhe pasqyrojne rezultatet e vitit te kaluar financiar , si dhe gjendjen financiare te shoqerise. Ai verifikon librat e llogarive, si dhe fondet e shoqerise , kontrollon pershtatjen e kontabilitetit me ligjin ne fuqi, verifikon perputhjen me llogarite vjetore te informacionit te dhe ne raportin e administrimit, kontrollon ghithe librat e llogarise, dokumentat kontabel dhe regjistrat e proces-verbaleve. Mund te aktivizojte eksperte dhe bashkepuntore per te perballuar volumin e punes, por duke marre me pare miratimin e ortakut te vetem.

13.3. Shkarkimi i Ekspertit kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kushte si emerimi nga ana e ortakeve.

Kreu VII

PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Neni 14

14.1. Shoqeria mund te prishet ne cdo kohe dhe per cfaredo lloj shkak, si ne rast falimentimi, privim te te drejtave per te ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktore te tjere qe nuk varen nga Ortaket.

14.2. Shoqeria hyn ne fazen e likujdimit qe ne momentin e prishjes se saj .Per kryerjen e ketij procesi, ortaket emerojne nje ose disa likujdatore, te cilet i paraqesin atij raportin mbi gjendjen e aktivitet dhe pasivit te Shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe afatin e nevojshem te perfundimit te tyre.

14.3. Ne fund te procesit te likujdimit, ortaket vendosen mbi bilancin perfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmerise se punes se likuduesit, dhe mbylljen e procesit te likujdimit.

14.4. Pas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeseve te kapilit themeltar tek kontribuesit perkates, likujdatori ndan kapitalet e mbetura per ortaket e shoqerise.

Neni 15. Zgjidhja e mosmarrveshjeve

15.1. Mosmarrveshjet midis ortakeve, shoqerise dhe te treteve ne rast se nuk zgjidhen me mirekuptim, kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor.

Kreu VIII

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 16

16.1. Per sa nuk eshte e parashikuar ne kete Statut, do t'i behet referim ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", si dhe legjislacionit koherent

16.2. Ky staut hartohet ne 4 (kater) kopje, secila me te njejten vlere ligjore. Njera prej kopjeve ruhet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

ORTAKET

Z.Doriana Frakulli

Z.Bledar Qalliu